



GREEN Solution

Tirana, Albania. Tel: +355 69 83 90 970

**PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE
E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

EMËRTIMI I AKTIVITETIT:

PRODHIM I MAKINERIVE DHE PAJISJEVE, LYERJE DHE SALDIM I METALEVE.

VENDODHJA:

**QARKU DURRËS, BASHKIA DURRËS, SHKOZET, LAGJJA 14, RRUGA "BAJRAM
TUSHA", ZONA KADASTRALE 8516, GODINË NR.2934.**

(Sipas shtojces 1 te Ligjit Nr. 52/2020, date 30.04.2022 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar: ID 7.12 pika i. Veprimtari të tjera të lyerjes/veshjes përfshirë ato të metalit, plastikës, tekstileve (me përjashtim të stampimit/printimit me makinë shtypi rotativë të tekstileve), pëlhurave, filmit dhe letrës; ID 7.12 pika k. Përpunimi dhe saldimi i metaleve; ID 10.1 Prodhim i makinerive dhe pajisjeve.)

Ndryshim i kushteve te lejes se mjedisit tipi B me PN-7679-12-2018

Kërkues:

Subjekti "RALBA TECNICH" SHPK

NIPT: L61622501B

Ky raport paraparak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u hartua nga Studio:

"GREEN Solution"

Laert Shehu

Administrator



Shkurt, 2022

NJOFTIM

Drejtuar : Agjencise Kombetare te Mjedisit

Lenda: Kerkese per zhvillimin e procedures se degjeses me publikun

Shoqeria "RALBA TECNICH" Sh.p.k njofton Agjencine Kombetare te Mjedisit per zhvillimin e procedures se informimit te publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit B per instalimin:

- ID 7.12 pika i. Veprimtari të tjera të lyerjes/veshjes përfshirë ato të metalit, plastikës, tekstileve (me përjashtim të stampimit/printimit me makinë shtypi rotativë të tekstileve), pëlhurave, filmit dhe letrës.
- ID 7.12 pika k. Përpunimi dhe saldimi i metaleve.
- ID 10.1 Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, me vendndodhje Durres, Shkozet, Lagjja 14, Rruga "Bajram Tusha", Zona Kadastrale 8516, Godinë Nr.2934.

Ky njoftim hartohet Referuar VKM 419, date 25.06.2014 , Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" te ndryshuar, kreu VI "Informimi dhe pjesemarrja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B", bashkangjitur gjeni dokumentacionin e kerkuar, sipas pikes 2 te ketij kreu:

- a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo **"Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B"**.
- b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
- c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
- d) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
- e) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
- f) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
- g) Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
- h) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
- i) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit

a. Kërkesa për vendosjen në funksionim të instalimit “Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, lyerje dhe saldimit të metaleve” është për aplikim **per ndryshim të kushteve të lejes mjedisore të tipi B me numer PN-7679-12-2018**, sipas Shtojces 1, të Ligjit Nr. 52/2020, datë 30.04.2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar”, -

- ID 7.12 pika i. Veprimtari të tjera të lyerjes/veshjes përfshirë ato të metalit, plastikës, tekstileve (me përjashtim të stampimit/printimit me makinë shtypi rotativë të tekstileve), pëlhurave, filmit dhe letrës.
- ID 7.12 pika k. Përpunimi dhe saldimit i metaleve.
- ID 10.1 Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, me vendndodhje Durrës, Shkozë, Lagjja 14, Rruga “Bajram Tusha”, Zona Kadastrale 8516, Godinë Nr.2934.

b. TË DHENAT E EKSTRAKTIT TË QKB-SE



EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L61622501B
2. Data e Regjistrimit	22/04/2016
3. Emri i Subjektit	RALBA TECNICH
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	19/04/2016
6. Kohëzgjatja	Nga: 19/04/2016
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Durrës Durrës DURRES Lagjja 14, Rruga Bajram Tusha, Godinë Nr.2934, Zona Kadastrale 8516, Shkozë
8. Kapitali	10.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Prodhim mekanik i pajisjeve elektrike, elektronike dhe të makinerive të avancuara teknologjiksht, krijimi i modeleve dhe krijimin e strukturave metalike. Aktivitet në fushën e regjimit të përpunimit aktiv, Fason. Import, eksport, tregtim të materialeve dhe produkteve të sipër përmendura dhe artikujve të ndryshëm industrialë, etj. Import, eksport, tregtim të makinerive të ndryshme e mjeteve industriale. Transporti dhe magazinimi për vete dhe të tretë, të materialeve, nënprodukteve ose produkteve të sipër përmendura. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo operacion tregtar, industrial, mobiliare, imobiliar dhe financiar të nevojshëm dhe të domosdoshëm për përmbushjen e qëllimit social, brenda kufijve ligjor, lidhjen e kontratave të kredive, vënia e garancive, garancive hipotekore e të garancive të tjera reale të tretëve, përfshirë institutet e kredive, pjesëmarrjen me kuota në shoqëri të tjera të krijuara ose që do të krijohen që kanë objekt të ngjashëm ose komplementar me të sajën, brenda kufijve të parashikuara nga ligji. Tregtim me shumicë, import, eksport të detergjentëve dhe dezinfektantëve të të gjitha llojeve.
10. Administratori/ët	Andrea Rotondi

c. ADRESA E VENDNDODHJES SE INSTALIMIT

Emri i instalimit/impianitit ¹	Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve dhe Industrinë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve		
Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti	Durrës, Shkozë, Lagjja 14, Rruga “Bajram Tusha”, Zona Kadastrale 8516, Godinë Nr.2934.		
Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	Koordinatat në sistemin Gaus-Kruger		
	Nr.	Koordinatat Y	Koordinatat X
	1	4372368.03	4577182.34
	2	4372401.51	4577144.97
	3	4372443.82	4577181.61
	4	4372411.47	4577219.11
Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi ²	<ul style="list-style-type: none"> - ID 7.12 pika i. Veprimtari të tjera të lyerjes/veshjes përfshirë ato të metalit, plastikës, tekstileve (me përjashtim të stampimit/printimit me makinë shtypi rotativë të tekstileve), pëlhurave, filmit dhe letrës. - ID 7.12 pika k. Përpunimi dhe saldimit i metaleve. - ID 10.1 Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, 		
Kapaciteti i projektuar	Kapaciteti kufi për lejet e tipit B të gjitha instalimet dhe për aktivitetin e saldimit kapacitet të barabartë ose më shumë se 5 ton/ditë metal.		

¹ Përkrahur titullin sipas kolumnës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për Lejet e mjedisit

² Shkruani kodet e specifikuar në kolumnën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuar në kolumnën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

Pamje satelitore e vendodhjes se aktivitetit



d. PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE QE PARASHIKOHET TE ZHVILLOHET

AKTIVITETI: Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, lyerje dhe saldime të metaleve
Adresa: Qarku Durres, Bashkia Durres, Shkozet, Lagjja 14, Rruga "Bajram Tusha", Zona Kadastrale 8516, Godinë Nr.2934.
Subjekti: "RALBA TECNICH" Sh.p.k
Administrator: Z. Andrea Rotondi

- **Hyrje**

Profili i shoqërisë "RALBA TECNICH" Sh.p.k

Aktiviteti i prodhimit të makinerive dhe pajisjeve, lyerjes dhe saldimit të metaleve të shoqërisë "RALBA TECNICH" shpk është vendosur në Qarkun Durres, Bashkia Durres, Shkozet, Lagjja 14, Rruga "Bajram Tusha", Zona Kadastrale 8516, Godinë Nr.2934. Subjekti kryen aktivitetet në fushën "Prodhim mekanik i pajisjeve elektrike, elektronike dhe të makinerive të avancuara teknologjikut, krijimi i modeleve dhe krijimin e strukturave metalike. Aktivitetet në fushën erezimit të përpunimit aktiv, Fason. Import, eksport, tregtim të materialeve dhe produkteve të sipër përmendura dhe artikujve të ndryshëm industrialë, etj. Import, eksport, tregtim të makinerive të ndryshme e mjeteve industriale. Transporti dhe magazinimi për vete dhe të tretë, të materialeve, nënprodukteve ose produkteve të sipërpërmendura. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo operacion tregtar, industrial, mobilie, imobiliar dhe financiar të nevojshëm dhe të domosdoshëm për përmbushjen e qëllimit social, brenda kufijve ligjor, lidhjen e kontratave të kredive, vënia e garancive, garancive hipotekore e të garancive të tjera reale të tretëve, përfshirë institutet e kredive, pjesëmarrjen me kuota në shoqëri të tjeratë krijuara ose që do të krijohen që kanë objekt të ngjashëm ose komplementar me të sajën, brenda kufijve të parashikuara nga ligji. Tregtim me

shumicë, import, eksport të detergjentëve dhe dezinfektantëve të të gjitha llojeve., me Nr NIPT: L61622501B. Pronat ku do të zhvillohet aktiviteti plotesoje kushtet teknike dhe hapesirat e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë për “Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, lyerje dhe saldimit të metaleve”.

Informacion mbi kompaninë “RALBA TECNICH” sh.p.k

Shoqëria “RALBA TECNICH” sh.p.k është një subjekt i regjistruar dhe zhvillon aktivitetin e saj ekonomik në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, lyerje dhe saldimit të metaleve. Qëllimi i firmës ka qenë dhe mbetet përmbushja e kërkesave të cilësive dhe për këtë kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilësive në të gjitha hallkat e saj.

Aktiviteti i subjektit është “Prodhim i makinerive dhe pajisjeve”, me vendodhje Durrës, Lagjia 14, Rruga “Bajram Tusha”, Godinë Nr.2934, Zona Kadastrale 8516, Shkozë. Për këtë aktivitet subjekti është i pajisur me Leje Mjedisit Tipi B, me kodin III.1.B, me numer **PN-7679-12-2018, datë 10.12.2018.**

Sa më sipër, për këtë aktivitet, subjekti ka paraqitur interes për zgjerimin e tij, duke shtuar disa makineri dhe pajisje të tjera. Përveç këtyre, në këtë ndryshim do të ketë edhe shtim të kapacitetit të projektuar të prodhimit, si dhe saktësim të klasifikimit të veprimtarisë sipas ndryshimeve të ligjit të ri (Referuar Ligjit Nr. 52/2020 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e mjedisit” të ndryshuar”). Për këtë aktivitet janë shtuar makineri tip torno 8 cope, freza 7 cope, 1 robot i vogël për lyerjen e metaleve, pasi lyerja ekzistuese ka qenë në mënyrë manuale dhe tani do të bëhet robotike, si dhe një furë për tharjen e bojës, e cila përdoret si lëndë djegëse gaz GLN.

Për këtë qëllim, subjekti “RALBA TECNICH” sh.p.k referuar VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisit të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” të ndryshuar ka plotësuar Formularin e Kërkesës për t’u pajisur me ndryshimin e kushteve të Lejes së Mjedisit të tipit B për aktivitetin “Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, lyerje dhe saldimit të metaleve”, me vendndodhje në Qarkun Durrës, Bashkia Durrës, Shkozë, Lagjia 14, Rruga “Bajram Tusha”, Zona Kadastrale 8516, Godinë Nr.2934, ka siguruar staf dhe pajisje profesionale për zhvillimin e këtij aktiviteti.

Vendosja e këtij instalimi në këtë zonë është e pershtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi është në distancë të konsiderueshme nga objektet apo veprat hidroenergjetike, etj, në zonën në studim është përqendruar një numër i madh i bizneseve me karakter industrial, kryesisht në fushën e tregëtimit të karburanteve, serviseve të makinave, markete ushqimore, bar-kafe, restorant etj.

Qëllimi i këtij aktiviteti është Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, lyerje dhe saldimit të metaleve.

Aktiviteti zhvillohet në një ambient të pershtatshëm për këtë aktivitet duke mos krijuar kështu dëm apo efekte negative të ndryshme në mjedisin përreth. Objekti është ndërtim i viteve të fundit dhe është i pajisur me të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin e këtij aktiviteti. Gjithashtu në këtë ambient bëjnë pjesë edhe hapesirat për levizjen e mjeteve, njerezve dhe sipërfaqet e gjelbera, oborri i cili është i gjelberuar anash me bimesinë karakteristike të këtyre ambienteve.

Ky aktivitet në teresinë e tij përbehet nga një proces pune i thjeshtë i cili konsiston kryesisht në proceset mekanike të punës. Në mënyrë të përmblodhur, procesi teknologjik është si më poshtë:

Lenda e parë për prodhimin e makinave laresë (lavatriçeve profesionale) / tharësve të rrobave dhe tavolinave industriale për hekurosje janë tabaket e llamarinës, të cilët mbërrin për 70% pjesë tashme të prera nga firma të jashtme ose nga vendet fqinje, kryesisht Italia.

- a) Fillimisht tabaket e llamarines i nenshtrohen proçesit te prerjes nepermjet makinerive prerese me te ftohte, te cilat presin materialin sipas permasave te projektuara ne AutoCAD per te minimizuar mbetjet. Prerja behet me makineri me Kontroll Numerik CNC, "CE" ne te ftohte pa leshuar tym ose gazra apo pluhra te cdo lloji ne ambient.
- b) Pas kesaj, pjeset e llamarines kalojne ne makinerite metalperthyes, te cilat bejne te mundur perthyerjen e tyre sipas permasave te projektuara.
- c) Proçesi i perthyerjes se llamarines ne forme harku behet duke zbatuar projektin ne AutoCAD, me makinerine e perthyerjes me Kontroll Numerik CNC, "CE".
- d) Proçesi i prerjes se llamarines ne pjese me te vogla behet ne te ftohte me sharre. Makineria e sharres funksionon me cikel te mbyllur riqarkullues. Uji qe perdoret per sistemin ftohes te makinerise, eshte me sistem riqarkullimi, me cikel te mbyllur. Merret nepermjet nje depozite uji, e cila eshte e lidhur me makinerine e sharres nepermjet nje sistemi tubacionesh, te cilat bejne te mundur riqarkullimin e ujit. Proçes 100% i mbyllur. Ne kete depozite ne forme konike, mundesohet edhe ftohja e ujit.
- e) Proçesi i bashkimit te elementeve behet nepermjet saldimit me saldatriçe TIG (80%) dhe saldimit me fije MIG/MAG (20%). Proçesi i saldimit ze vetem 5% te ciklit te prodhimit.
- f) Pas bashkimit te elementeve me njeri-tjetrin, behet montimi/modelimi i llamarinave duke krijuar strukturen skeletike te pajisjes/makinerise, ku me pas kryhet montimi i motorreve dhe kuadrot, te cilat sigurohen si produkte te gatshme nga Italia. Pas ketyre proçeseve produkti del 15 % i gatshem.
- g) Disa nga pjeset dergohen per trajtim te vecante tek firma te specializuara per mbrojtjen siperfaqesore nga faktoret e jashtem nepermjet lyerjes dhe galvanizimit. Vetem pasi keto elemente rikthehen tek Ralba Tecnich fillon proçesi i vertete i brendshem qe ze rreth 85% te prodhimit, dmth montimin e komponenteve te mekanikes, elektrikes, elektronikes, pneumatikes qe jane pjese perberese te se njejtës makineri dhe qe tashme kane mberritur nga Italia te para-perfunduara.

Te gjitha makinerite dhe pajisjet qe disponojme jane markave me te mira ne kete fushe dhe me çertifikate "CE", jane te pajisura me sensore elektromekanik, sensor akustik, sistem ventilimi, sistem ajrimi, etj. Nuk vleresohet aktivitetet me mbetje te ngurta sasiore, pasi perqindja e mbetjes teknologjike eshte shume e vogel (me pak se 1%).

subjekti ka paraqitur interes për zgjerimin e tij, duke shtuar disa makineri dhe pajisje te tjera te tipit torno 8 cope, freza 7 cope, 1 robot i vogel per lyerjen e metaleve, pasi lyerja ekzistuese ka qene ne menyre manuale dhe tani do te behet robotike, si dhe nje furre per tharjen e bojës, e cila perdor si lende djegese gaz GLN.

Per kryerjen e proçeseve teknologjike, punonjesit e kompanise tone jane trajnuar jashte vendit per kryerjen e proçeve te punes me profesionalizem, eficiency te larte, respektimin e standardeve te kerkuara ne prodhim sipas kartes teknologjike te produktit, standardit, si dhe te qenit sa me miqesore ndaj mjedisit.

Ne ambientin e punes, veçanerisht gjate kryerjes se proçeseve te punes punonjesit jane te pajisur me uniforma pune, dorashka pune sipas proçesit, Tuta meshine, maska saldimi, kufje, syze, etj. Ambientet e jashtme dhe te brendshme te magazines jane te pajisura me tabela drejtuse, sinjalizuse dhe parandaluese te aksidenteve ne pune dhe mbajtjen paster te mjedisit.

Ne ambientet e prodhimit ndalohet rreptesisht hyrja e personave te pa autorizuar. Vizitoret qe lejohen te hyjne pajisen me karte vizitori dhe shoqerohen nga stafi yne.

Produkti gjysem i gatshem magazinohet ne repartin e magazinimit, duke qendruar aty per nje kohe te shkurter jo me shume se nje jave dhe me pas eksportohet drejt vendit fqinj, Italia.

Kompania jone vazhdimisht merr masa per te qene sa me miqesore me mjedisin perreth duke mbjelle peme dhe duke gjelberuar mjediset ne territorin ku zhvillon aktivitetin, duke mbajtur paster dhe mos krijuar ndotje dhe shqetesime ne ambientet qe disponon dhe perreth saj.

Ne ambjentet e brendshme te objektit ku zhvillohet aktiviteti jane krijuar kushte dhe ambjente ne funksion te punonjesve si: Dhome Mjeku per kryerjen e vizitave periodike e te shpeshta te punonjesve nga mjek me pervojë, Kutia e Ndhimes se Shpejte ne rastet e aksidenteve ne pune, Mense per te pushuar dhe konsumuar vaktet e ushqimit ose kafe nga ana e stafit, ambjente higjieno-sanitare te ndara, Zyrat per administraten, dhome mbledhjesh dhe trajnimesh, ambjente te gjelberuara perreth objektit ne menyre qe te krijohen edhe kushtet ç`lodhese dhe rekreative.

- **Ndërtimi i linjës elektrike**

Në varësi të llojit të pajisjeve dhe fuqisë së instaluar është zgjedhur edhe fuqia e transformatorit të kabinës elektrike. Aktualisht rrejtja e shpërndarjes së energjisë elektrike është në gjendje mjaft të mirë dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Objekti është i pajisur me kasete të shpërndarjes së energjisë elektrike. Per mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike është parashikuar një rrjet tokezimi dhe sisteme tokezimi te vecanta per çdo pajisje.

- **Rruga hyrëse për në objekt dhe rrugët e brendshme**

Objekti lidhet me rrugën kryesore “Bajram Tusha”, ç’ka ben te mundur qe ky objekt te mos ndikojë ne trafikun e zones. Rruga e cila të dërgon në hyrje të objektit është ekzistuese dhe në gjendje mjaft të mirë e shtruar me asfalt dhe e niveluar sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke mundesuar levizjen e lire te mjeteve. Gjithashtu pergjate gjithë gjatesise se infrastruktures se brendshme është ndertuar edhe rrjeti i drenazhimeve te ujrave te shiut.

Në afërsi të zonës ku zhvillon aktivitetin subjekti “**RALBA TECNICH**” shpk nuk ka shkolla, vepra arti, argjinatura, linjë elektrike të tensionit të lartë dhe linjë uji që mund të dëmtohen nga zhvillimi i aktivitetit për “**Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, lyerje dhe saldim i metaleve**”.

Foto te objektit ku do te zhvillohet aktiviteti



Pamje e ambienteve te brendshem ku do te kryhet aktiviteti







e. PERMBLEDHJA NE GJUHE JO-TEKNIKE

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- **INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ;**
- “Veprimtaritë e mbulimit të sipërfaqes dhe të stampimit”
 - ID 7.12 pika i. Veprimtari të tjera të lyerjes/veshjes përfshirë ato të metalit, plastikës, tekstileve (me përjashtim të stampimit/printimit me makinë shtypi rotativë të tekstileve), pëlhurave, filmit dhe letrës.
 - ID 7.12 pika k. Përpunimi dhe saldimi i metaleve.
 - ID 10.1 Prodhim i makinerive dhe pajisjeve.

- **LËNDËT E PARA DHE ATO NDIHMËSE, SUBSTANCAT E TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NGA INSTALIMI;**

Lenda e pare per prodhimin e makinave larese (lavatriçeve profesionale) / thareseve te rrobave dhe tavolinave industriale per hekurosje jane tabaket e llamarines, te cilet mberrijne per 70% pjese tashme te prera nga firma te jashtme ose nga nga vendet fqinje, kryesisht Italia.

Lendet e para te furnizuara gjate marrjes ne dorezim inventarizohen nga stafi. Ato kontrollohen per gjendjen fizike te tyre nese plotesojne standardin e kerkuar. Ato magazinohen per nje kohe fare te shkurter ne objekt pasi futen direkt ne procesin e prodhimit. Ndersa ne repartin e lyerjes te metaleve, lendet e para qe perdoren jane bojra te ndryshme.

- **KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES;**

Zona ku do te zhvillohet aktiviteti “Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, lyerje dhe saldim i metaleve”, ndodhet ne Durres, Lagjja 14, Rruga Bajram Tusha, Godinë Nr.2934, Zona Kadastrale 8516, Shkozet.

Ne kete zone jane te perqendruar nje numer i konsiderueshem i subjekteve qe operojne ne fushen e tregtimit te karburanteve, riparimin e mjeteve, market ushqimore, bar-kafe, restorante, etj.

• **IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE**

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njerren prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i aktivitetit “Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, lyerje dhe saldim i metaleve”. Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Efektet e mundshme nga aktiviteti qe ushtrohet do te vleresohen ne menyre te pergjithshme nga ky raport i ndikimeve në mjedis. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi “Ndotësi paguan”
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera
- b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit.

Shkarkime ne uje

Ky aktivitet nuk ka shkarkime te ujerave teknologjik ne mjedisin perreth. Makineria e sharres funksionon me cikel te mbyllur riqarkullues. Uji qe perdoret per sistemin ftohes te makinerise, eshte me sistem riqarkullimi, me cikel te mbyllur. Merret nepermjet nje depozite uji e cila eshte e lidhur me makinerine e sharres nepermjet nje sistemi tubacionesh te cilat bejne te mundur riqarkullimin e ujit. Proçes 100% i mbyllur. Ne kete depozite ne forme konike, mundesohet edhe ftohja e ujit. Shkarkime te ujerave te perdorur mund te permendim vetem ujerat higjenosanitare te ambjenteve te tualeteve dhe te larjes e pastrimit te ambjenteve te punes. Keto ujera shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones.

Emetimet ne ajer

Emetime ne ajer nga ky aktivitet vijne kryesisht nga makinerite prerese dhe shpuese te llamarinave, kryesisht pluhur, por kjo ne sasi jo te konsiderueshme. Objekti ku zhvillohet aktiviteti eshte i pajisur ne te katerta anet e tij me dritare, te cilat bejne te mundur qarkullimin e ajrit ne ambjentet e magazines. Gjate proceseve te punes, punonjesit perdorin masa mbrojtese si syze, maska per ruajtjen e shendetit te tyre.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat qe prodhohen ne kete aktivitet vijne kryesisht nga makinerite prerese, makinerite shpuese te llamarinave, etj. Proçesi i prodhimit shoqerohet me çlirim zhurme, por keto zhurma mbeten brenda ambjentit te punes, nuk vleresohet ne nivele te tilla sa qe te jene e shqetesuese per zonen, madje, ne ambjentet e jashtme te kapanonit, keto zhurma jane te pa ndjeshme. (per kete subjekti duhet te kryeje nje testim nga laboratore te akredituar). Punonjesit e ekspozuar ndaj burimeve te zhurmës, perdorin vazhdimisht kufje mbrojtese.

Ndikimi ne toke

Proceset e punes nuk ndikojne ne toke per shkak te ambjenteve te pershtatshme e bashkekohore, te shtruara me beton dhe objekt te mbuluar.

Ndikimi ne Biodiversitet

Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e mbrojtura me ligj, lloji i aktivitetit per vendodhjen qe ka nuk ndikon ne demtimin e biodiversitetit te zones.

Ndikimi ne Mjedisin Social

Ndikimi i ketij aktiviteti ne mjedisin social, eshte pozitiv persa i perkete punesimit, sherbimit te prodhimit e shitjes se ketyre produkteve. Kushtet teknike, kushtet e punes, kushtet mjedisore qe ka zbatuar ky investim, sherbejne edhe si nje shembull per siper marrjet private e publike vendase duke zbatuar standarte Europiane dhe duke punuar duke menduar per nje mjedis me te paster dhe cilesi jete me te mire.

Mbetjet e prodhuara

Ky aktivitet nuk ka prodhim mbetjesh te ngurta, pasi lenda e pare te cilet jane tabaket e llamarinës mberrijne ne magazinën ku zhvillohet aktiviteti me permasa te sakta, rreth 70% pjese te prera nga firma e jashtme. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta sasiore, pasi perqindja e mbetjes teknologjike, pluhuri eshte shume e vogel (me pak se 1%), pothuajse e paperfillshme. Mbetjet qe prodhohen jane mbetje urbane nga aktiviteti human, te tilla si: mbetje plastike, qelqi, qese dhe kartona nga ambalazhet etj.

Klasifikimi i ketyre mbetjeve sipas Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve eshte si me poshte:

Mbetjet urbane nga aktiviteti human

20 01 01	Letër dhe karton
20 01 02	Qelq
20 01 39	Plastikët
20 01 40	Metalet

- **TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME;**

Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ

Rekomandime për zbutjen e ndikimeve	
Toka	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave dhënë në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
Erozioni	
Mbrojtja nga erozioni	Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e linjës së Prodhim i makinerive dhe pajisjeve, lysterje dhe saldim i metaleve Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave te pastrimit. Mbjellja e pemëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirembajtja e bazamentit ku janë të instaluar linja për Prodhimin e makinerive dhe pajisjeve, lysterje dhe saldim i metaleve
Biodiversiteti	
Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit	Mirembajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve të rinj, përgjatë rrugës që bëhen të mundur hyrjen për në objekt.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve në ajër nga proceset	Mirembajtja e sistemit të aspirimit, ndërrimi periodik i filtrave sipas kapacitetit mbajtes. Procesi i lysterjes dhe tharjes së bojës të kryhet vetëm në ambientin e brendshëm të furrës Pastrimi periodik i linjës së prodhimit, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse për frymarrjen, maska me karbon. Mjete me kolaudim optimal. Pjesë këmbimi rezerve brenda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburantit cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i linjës së prodhimit dhe lysterjes duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.
Sistemi i drenazhimit	
Sistemi i drenazhimit	Mirembajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave te pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një vaske dekantimi të përbashkët dhe riciklimi, ripërdorim i ujrave.
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve urbane nga aktiviteti dhe punonjësit që do të operojnë në objekt.	Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në venddepozitim më të afërt të caktuar nga njësi vendore. Asgjësimi i mbetjeve që vijnë nga proceset e prodhimit dhe lysterjes nga kompani të licensuara.

Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti/ instalimet dhe nga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i instalimeve brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.
Trafiku rrugor	
Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve	Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do të levizin brenda normave të lejuara të shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

- Ndjekja e gjithë kërkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.
- Aktiviteti kryesisht do të zhvillohet në ambjent të mbyllur kështu që nuk do të ketë nivele zhurmash domethënëse për zonën përreth. Do të bëhet pajisja e punonjësve me mjete mbrojtëse personale.
- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të ketë ndikime në ndryshimin e habitateve
- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe pajisjes së punonjësve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë.

Për më tepër rekomandimet për të parandaluar dhe kontrolluar rrezikun e ndotjes përfshijme:

- Mbetjet urbane të përdorshme të grumbullohen transportohen dhe depozitohen në oraret e caktuara nga Njësia Vendore.
- Të realizohet ndriçimi përreth (vendosja e impiantit të ndricimit).
- Të kryhet rregullimi i territorit në përputhje me kondicionet urbane të përcaktuara.
- Shoqëria të operojë në përputhje të plote me normat që janë në fuqi, dhe të kryej monitorime të vazhdueshme të tregueseve mjedisore të trysnise në mjedis.
- Të respektojnë të gjitha rregullat e mbrojtjes kundër zjarrit gjatë operimit në ndërtesë dhe të respektojnë rregulloren e MKZ.
- Mbetjet e rrezikshme të grumbullohen, transportohen dhe asgjësohen nga subjekte të licencuara.
- Të instalohen dhe të respektohen sinjalistikat e trafikut të cilat do të minimizojnë impaktin për aksidente të mundshme.
- Për të minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, të limitohen proceset e zhurmshme gjatë orëve me të ndjeshme, ndërmjet orës 20 deri në 07 të mëngjesit.
- Të respektojnë të gjitha kushtet dhe masat që do të vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga vlerësimet e mesipërme, shkarkimet e pritshme në mjedis janë të ulëta dhe nuk përbejnë problem serioz për mjedisin. Megjithatë përparësitë që ka ky aktivitet, duhet të tregohet kujdes në menaxhimin dhe mbajtjen nën kontroll të kushteve teknike për të minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet. Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që duhet të zbatohen nga investitori për mbare funksionimin e aktivitetit dhe ruajtjen e mjedisit fizik e biologjik.

- Në sheshin e aktivitetit, nuk duhet të magazinohen materiale të rrezikshme.
- Të ajroset vazhdimisht ambjenti i punës dhe punonjësit gjatë lëvizjes së lustrimit të përdorin maska mbrojtëse me fibra karboni e sistem tjetër të kapjes së pluhurave të imeta. (teper e rëndësishme për shëndetin e punonjësve).
- Punëtorët që do të ndodhen në mjedisë ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin duhet të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e dëgjimit (Kufje ose tapa për veshet).
- Të mos punohet në orët e vona, pasi afërsia me banesat mund të shndërrohet në një shqetësim serioz për banorët e zonës.

- Te gjitha mbetjet e ngurta te menaxhohen ne bashkepunim me subjekte te licensuara per menaxhimin e tyre.
- Te perdoren bojera ekologjike dhe te mos derdhen ne asnje menyre ne sistemin e kanalizimeve.
- Te nderrohen shpesh filtrat dhe aspiratoret per nje funksionim optimal te tyre dhe per reduktimin e zhurmes.
- Filtrat e pastrimit te ajrit te menaxhohen nga subjekte te licensuara per kete lloj aktiviteti.

Masat qe duhen konsideruar per te minimizuar ndikimin ne mjedis jane:

- Parandalimi i shkarkimeve te pluhurave te demshem ne mjedis.
- Lidhur me mbetjet e grumbulluara, diferencuara dhe ambalazuara te menaxhohen ne bashkepunim me subjekte te licensuara per riciklimin e metejsheem te tyre.
- Sasia depozituese te mos i kaloje volumet e parashikuara ne menyre qe situata te jete e kontrollueshme dhe te mos demtoje instalimin.
- Te zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri ne menyre qe te perballoje siperfaqen ne rastet e avarive te ndryshme.
- Punonjesit te jene te trajnuar paraprakisht dhe te jene vazhdimisht ne mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjate proceseve te punes. Punimet e mirembajtjes te kryhen ne perputhje me kushtet teknike te punes.
- Te mirembahet brezi i pemeve pergjate murit rrethues te prones, ne menyre qe te reduktoje impaktin ne peizazh.

- **Zbatimi i normave të rregullores së teknikës së sigurimit**

Gjatë ushtrimit të aktivitetit per Prodhimin e makinerive dhe pajisjeve, lyerje dhe saldim i metaleve subjekti duhet të mbajë parasysh që problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë më të rëndësishmet dhe me të mprehta dhe kërkojnë vlerësim serioz.

Para së gjithash në të gjitha operacionet jane punesuar specialistë me eksperiencë pune në kryerjen e proceseve të ndryshme të linjes se Prodhimit te makinerive dhe pajisjeve, lyerjes dhe saldimit te metaleve.

Regullorja e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik të punimeve dhe subjektit, do të zbatohet në çdo proces pune të përcaktuar në plan organizimin e kryerjes së punimeve të hartuar nga ai dhe të miratuar nga drejtuesit e firmës.

Plan organizimi i punimeve do të hartohet para fillimit të funksionimit te linjes se prodhimit.

Drejtuesi teknik i punimeve ose personi i ngarkuar do të bëjë kontrollin teknik dhe azhornimin e saktë të prodhimit të cdo lloji për të cilat subjekti ka marre licensë.

Rradha e kryerjes do të përcaktohet hollësisht në planin e masave tekniko organizative dhe do të miratohet nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë.

Drejtuesi teknik do të kryeje instruktme të rregullta mujore e tre mujore, ku do të trajtohen tema të vecanta për të gjithë punonjesit.

PLANI I MANAXHIMIT MJEDISOR

- **PMM-ja për një komponent Projekti apo një nënprojekt do të përmbajë:**
 - Vlerësimin e impakteve mjedisore të parashikuara në faza të ndryshme, veçanërisht gjatë funksionimit (përfshirë mirëmbajtjen) dhe dekomisionimit, periudhat kohore gjatë të cilave do të kryen fazat e mësipërme, shkallën e tyre, qëllimin dhe pasoja.
 - Përcaktimin e nivelit të pranueshëm të secilit impakt, veçanërisht në lidhje me periudhën kohore, zgjatjen në kohë, shkallën, pasojën, koston dhe nivelet e lejuara ligjore.
 - Kushtet dhe masat që duhen ndërmarrë për të zbutur këto impakte që ka mundësi të dalin në çdo fazë, cilët do të jenë përgjegjës për to, nëse duhet përmirësuar projekti teknik, ose nëpërmjet masave mbrojtëse gjatë funksionimit, apo metoda të tjera, koston e mundshme, implikimet për përfundimet e projektit, etj.

- Burimet dhe metodat e kërkuara për monitorimin, matjen dhe vënien në zbatim të tyre (çfarë është për t'u matur, kur dhe ku, nga kush dhe pse); përgjegjësitë institucionale për secilin veprim; dhe kërkesat e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve, dhe kostot përkatëse të secilit element.
- PMM-ja do të përmbajë dy dokumente të veçanta: një Plan Zbutës dhe një Plan Monitorues. Pritet që të përgatiten në kohën e finalizimit të përfundimit të projektit teknik dhe duhet të përmbajë të gjitha kërkesat e specifikuar në miratimin e Lejes Mjedisore të lëshuar nga AKM-ja.
- NJQV-ja ose propozuesit (nëse nuk janë të njëjtë) do të jenë përgjegjës për përgatitjen e PMM-së. Megjithatë në Termat e Referencës së projektuesit të projektit perfshihet përgatitja e PMM. Aty ku nënprojekti kërkon një VNM, do të kërkohe mendimi i specialistëve të VNM para se ky i fundit të finalizohet.

Masat lehtësuese që do të ndermerren gjatë funksionimit të linjes së lysterjes, lustrimit dhe riparimit të automjeteve.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga shoqëria për funksionimin e linjes së Prodhimit të makinerive dhe pajisjeve, lysterjes dhe saldimit të metaleve. Ndikimet negative në mjedis gjatë funksionimit të instalimeve janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndermerren janë përmendur në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

- Menaxhimi optimal dhe mirembajtja e linjes së Prodhimit të makinerive dhe pajisjeve, lysterjes dhe saldimit të metaleve.
- Mbetjet e ngurta urbane të papërdorshme që do të prodhohen në objekt të depozitohen në vendet e përcaktuara nga Njësia Vendore dhe të vendosen kontener të mjaftueshem për mbetjet për numrin e punonjësve, si dhe riciklimin e tyre nga subjekte të licencuara.
- Rikuperimi, Riciklimi dhe Ripërdorimi i mbetjeve të metalit
- Menaxhimi sa më eficient i lëndës së parë.
- Të respektohen oraret e operimit të punës brenda mjedisit ku zhvillohet aktiviteti për diferencimin.
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara.
- Zbatimi i niveleve kufi të zhurmave.

- ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR;

Shoqëria "RALBA TECNICH" Sh.p.k disponon dokument pronesie për pronën ku zhvillohet veprimtaria e cila është i pozicionuar Durrës, Lagjja 14, Rruga Bajram Tusha, Godinë Nr.2934, Zona Kadastrale 8516, Shkozë. Prona ku është ngritur objekti është ekzistuese, e pajisur me leje ndërtimi.

- MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME);

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve

Aktiviteti që zhvillon shoqëria "RALBA TECNICH" shpk, me vendodhje në Durrës, Lagjja 14, Rruga Bajram Tusha, Godinë Nr.2934, Zona Kadastrale 8516, Shkozë nga proceset e ndryshme të operimit të punës në objekt për Prodhimin e makinerive dhe pajisjeve, lysterjes dhe saldimit të metaleve.

Rymat prioritare të mbetjeve të gjeneruara në objekt dhe nga zhvillimi i aktivitetit ndahen sipas fraksioneve të mëposhtme:

- Mbetje të ngurta urbane (Mbetjet të ambalazhit, karton, plastik, kanaçe, etj)

Qëllimi i menaxhimit të mbetjeve: Diferencimi i mbetjeve të gjeneruara brenda objektit të shfrytëzuar, sipas fraksioneve kryesore nëpërmjet instalimit të sistemit me 3-Kontener, reduktimin e mbetjeve nga proceset e prodhimit, riciklimin dhe asgjësimin e mbetjeve dhe transportimi periodik të mbetjeve urbane në vendin e caktuar nga njësia vendore, përmes bashkëpunimit me NJQV-në, për firmat e kontraktuara në grumbullimin e mbetjeve urbane, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve, në ndërtimin e një infrastrukture të qëndrueshme në diferencimin e mbetjeve, duke maksimizuar dobinë e Landfillit

Rajonal (ku kryhet dhe asgjesimi përfundimtar i tyre, sipas Strategjisë Kombëtare të Mjedisit për Menaxhimin e Mbetjeve).

Menaxhimi i mbetjeve brenda zones së instalimit është tërësisht i bazuar në SKMM, PKMM, PRMM dhe Planin e Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkise.

- Mbetje nga zhvillimi i aktivitetit

Mbetje te ngurta qe prodhohen jane ato te copave te metaleve nga makineria e prerjes dhe sharres, gjate procesit te prerjes se tabakeve te llamarinave dhe mbetjet urbane nga aktiviteti human. Mbetjet e metaleve, duhet te menaxhohen ne bashkepunim me subjekte te licensuara per menaxhimin e tyre ne menyre te integruar ose mund te shiten per skrap per qellime riciklimi, ose menaxhim nga sherbimi i mbetjeve te ngurta urbane te rajonit.

Objektivat afatshkurtra dhe afatmesme të planit janë si më poshtë:

- Instalimi i sistemit me 3-kontenier brenda zones ku zhvillohet aktiviteti
- Diferencimi i mbetjeve, sipas tre rrymave prioritare (Plastik, Letër/Karton dhe Mbetje të tjera)
- Rikuperimi, Riciklimi dhe Riperdorimi ne maksimum te mbetjeve, duke rritur eficencen e vete linjes dhe reduktimin e kostos per asgjesimin e tyre
- Transportimi i mbetjeve të ngurta urbane në vendepozitimim e caktuar nga Njësia Vendore.

Synimet:

- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit, grumbullimin e mbetjeve në të gjithë territorin e objektit dhe diferencimin e mbetjeve sipas tre rrymave kryesore
- Organizimi i diferencuar i mbetjeve në përputhje me politikat kombëtare, për të mundësuar dhe stimuluar metodat e trajtimit të mbetjeve (riciklimi dhe riperdorim)
- Planifikimi dhe ngritja në nivelin zonal i një rrjeti të kontenierëve për diferencimin e mbetjeve me qëllim për të maksimizuar dobinë e Landfillit Rajonal
- Maksimizimi i përdorimit të mbetjeve urbane dhe mbetjeve teknologjike
- Maksimizimi per reduktimin e mbetjeve nga ushtrimi i aktivitetit
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe trajnimi i punonjësve të vetë shoqërisë, duke ofruar një eficiency dhe efektivitet në diferencimin dhe menaxhimin të integruar të mbetjeve
- Asgjesimin përfundimtar dhe maksiminimin e përdorimit te mbetjeve.

- MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:

Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin efcient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e Prodhimit te makinerive dhe pajisjeve, lysterjes dhe saldimit te metaleve:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet rrethimi i objektit dhe linjës së impiantit të prodhimit dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Te menaxhohen mbetjet e ngurta ne menyre te integruar dhe te zbatohen perkufizimet e Ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve".
- Punonjesit te pajisen dhe te perdorin rregullisht masat mbrojtese ne pune si veshje, maska, syze, tapa per veshet, kufje, etj me qellim ruajtjen e shendetit te tyre.

- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruar në këtë Formular-Kërkese për t'u pajisur me Leje Mjedisore Tipi B.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatorëve të mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmëndura më sipër.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjith kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së prodhimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

Masa lehtësuese të tjera të kërkuara

- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin vetëm brenda kordinatave të sipërfaqes së objektit të marre me qera.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar ndotjen, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Linja e prodhimit të instaluar në objekt, do të kolaudohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve për Prodhimin e makinerive dhe pajisjeve, lysterjes dhe saldimit të metaleve
- Maksimizimi i përdorimit të lëndës së parë
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njësia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selektive sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Mjedis i gjelbëruar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedisore të nevojshme.
- Rrjeti elektrik është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Zona ku do të realizohen operacioni i Prodhimit të makinerive dhe pajisjeve, lysterjes dhe saldimit të metaleve është e rrethuar, me qëllim për të shmangur hyrjet e paautorizuara të individëve dhe faunës së zonës përreth.
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundër zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe linjës së prodhimit.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksave, etj.
- Është ndërtuar sistemi i drenazhimit të ujërave teknologjike dhe lëvizjes së ujërave të shiut.

- Ndërsa në lidhje në burimet e furnizimit me ujë, janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat gjatë një viti, veçanërisht gjatë muajve të verës, kur normalisht kërkesa është më e lartë. Furnizimi me ujë sigurohet në një nivel të tillë presioni, në menyrë që të jetë i mjaftueshëm për të shpërndarë sasinë e nevojshme të ujit në të gjithë gjatësinë e objektit dhe instalimit, por jo aq sa të demtojë pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose të krijojë rreziqe tek impianti apo aparaturat dhe jetën e punonjësit.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në instalimet për lyerjen, lustrimin dhe riparimin e automjeteve.

- **MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.**

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për Prodhimin e makinerive dhe pajisjeve, lyerjes dhe saldimit të metaleve është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivi i vetëmonitorimit të shkarkimeve në mjedis është të evidentojë vlerat reale të treguesve mjedisorë të gjendjes, ndikimit dhe trysnisë në ajër, në ujëra të brendshme, në tokë, me qëllim që, në bazë të tyre, subjekti të ndërmarë masa dhe veprime korigjuese të përshtatëshme dhe të zbatueshme për zonën ku ushtron aktivitetin. Për rastet kur ka ndotje që ndikojnë në situatën e shëndetit publik dhe në mjedis, të përcaktojnë shkallën e ndotjes dhe nivelin e devijimit nga normat e lejuar, në mënyrë që programi rehabilitues të hartohet i sakte dhe masat e ndërhyrjes të jenë ato të duhurat dhe në nivelin e duhur.

Në varësi të nivelit të zhvillimit të ndikimit mjedisor, masat që ndërmeren mund të përfshijnë ndalimin/eliminimin e shkakut të ndikimit, ose mund të jenë të karakterit zbutës e reduktues.

Zgjidhja më e mirë, kur rrethanat e lejojnë, është ndalimi/eliminimi i ndotjes dhe shkaqeve të tjera.

Ne përgatitjen e programit të monitorimit specialistet kanë marrë në konsideratë mundësinë për të realizuar një monitorim realist të elementeve me ndikim në mjedis.

Subjekti merr përsipër sigurimin e ecurisë normale të punës dhe ruajtjen e vazhdueshme të mjedisit deri në mbylljen e aktivitetit.

Subjekti, gjithashtu, do të ketë lidhje të vazhdueshme me Agjensinë Kombëtare të Mjedisit, pranë të cilës do të informojë periodikisht për mbarvajtjen e punës si dhe për monitorimin e parametrave të mësipër.

Monitorimi dhe rekomandime

Monitorimi i cilësisë së mjedisit mbetet një ndër çështjet parësore.

Monitorim është procesi i zbulimit të ndryshimeve nëse do të ndodhin, përcaktimit të drejtimit dhe i matjes së shtrirjes së tyre.

Procesi i monitorimit do të përqëndrohet në të gjithë fazat e zhvillimit të projektit dhe fokusohet në aktivitet që gjenerojnë ndikime negative në mjedis në efektet e këtyre ndikimeve dhe në zbatimin e masave për zbutjen e tyre. Monitorimi do të kryhet nga vetë investori dhe në rast të pamundësisë teknike për realizimin e tyre do të kërkohet bashkëpunim i subjekteve të specializuara për fushat përkatëse.

Verifikimi i monitorimit apo auditimit do të organizohen nga institucionet administrative si AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit etj.

Në përputhje me karakteristikat e implementimit dhe të funksionimit të impiantit të magazinimit dhe furnizimit me gaz të lengshëm GLN dhe në përputhje me bazën ligjore mbi monitorimin, rekomandojmë të monitorohen këto elemente:

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 “Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë”

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të lejes së mjedisit dhe në rast të kundert, sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo tre ose gjashte muaj të dorezohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me foto, masat e marra për reduktimin e ndotjes në mjedis dhe menyrën e zbatimit të kushteve të lejes mjedisore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 “Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë”

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të lejes së mjedisit dhe në rast të kundert, sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo tre ose gjashte muaj të dorezohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me foto, masat e marra për reduktimin e ndotjes në mjedis dhe menyrën e zbatimit të kushteve të lejes mjedisore.

Regjistrimi i të dhënave mjedisore

Për të ruajtur të dhënat mjedisore të veprimtarisë do të përgatitet dhe mbahet një regjistër i veçantë ku do të pasqyrohen të gjitha parametrat e monitoruar nga shoqëria “RALBA TECNICH” Sh.p.k mirëmbajtja dhe përditësimin e regjistrit nga drejtuesi teknik i instalimit.

f. KONSULTIMET NDERKUFITARE

Zona ku zhvillohet do të zhvillohet aktiviteti nuk ka nevojë t’i nënshtrohet procesit të konsultimit nderkufitar.

g. AUTORITETI VENDIMARRËS PËR DHENIEN E AKTIT TË MIRATIMIT TË LEJES SË MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QË NDIQEN.

Autoriteti miratues është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit firmos për miratimin apo refuzimin e aplikimit për tu pajisur me leje mjedisit të tipi B, me propozim nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacionin e paraqitur nepermjet Qendres Kombetare të Biznesit.

Afati për marrjen në shqyrtim të aplikimit për pajisjen me leje mjedisit të tipit B është 40 dite pune.

h. ADRESA E AKM-SE, KU PUBLIKU MUND TË DERGOJE KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NË FORME ELEKTRONIKE, BRENTA 20 DITE NGA DATA E NJOFTIMIT.

Faqja zyrtare e Agjencisë Kombetare të Mjedisit: akm.gov.al